

"CILËSIA NË ARSIM"

PËRCEPTIMI I NXËNËSËVE RRETH
PËRMBAJTJES, PROCESIT DHE MJEDISIT MËSIMOR

PRISHTINË

**SCHÜLER
HELPEN
LEBEN**

KY^C KOSOVAR
YOUTH COUNCIL

 KNK

Këshilli i Nxënësve të Kosovës
Student Council of Kosova



Të drejtat e autorit © 2022. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

"PERCEPTIMI I NXËNËSVE TË SHKOLLIMIT TË MESËM TË LARTË PËR PËRMBAJTJEN, PROCESIN DHE MJEDISIN MËSIMOR"

RAPORTI I DETAJUAR PËR KOMUNËN E PRISHTINËS

Këshilli Rinor Kosovar
Rr. Kroj i Bardhë, nr.81, Dardani
Prishtinë 10000, Kosovë
kyckosova@gmail.com
+383 (44) 96 45 75

Autorë: Alex Klaus Matz
Dizajni: Ditjon Fetahu
Grumbullimin e të dhënave në terren:
Grupi i Monitoruesve të Rinjë (YMG)

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Fuqizimi i Këshillit të Nxënësve të Kosovës", me mbështetje të fondacionit Gjerman, Schuler Helfen Leben (SHL) dhe implementuar nga Këshilli Rinor Kosovar (KYC). Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

08Të gjeturat
kryesore**43**Procesi
Mësimor**11**

Hyrje

44Mjedisi
Mësimor**14**Qëllimi dhe
Objektivat**46**Përmbajtja
Mësimore**14**

Metodologjia

48

Kufizime

20Rezultatet
Sasiore**49**

Referencat

40Rezultatet
Cilësore**50**

Shtojcat I & II

43

Diskutimi

SHKURTESAT

APShK Asociacioni i Psikologëve Shkollorë të Kosovës

KAM Klubi për Arsim më të Mirë

KNK Këshilli i Nxënësve të Kosovës

KD Këshilli Drejtues i KNK

KDSh Këshilli Drejtues i Shkollës

KYC Kosovar Youth Council - Këshilli Rinor Kosovar

MASHTI Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

SHL Schüler Helfen Leben

ShML Shkolla e Mesme e Lartë

UA Udhëzimi Administrativ

ABSTRACT

Krahas raportit tashmë të lansuar mbi "Perceptimin e nxënësve të shkollave të mesme lidhur me përmbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor të arsimit" për Kosovën në përgjithësi; këto raporte të detajuara për komunat duhet të ofrojnë një kuptim më të saktë të situatës aktuale në terren.

TË GJETURAT KRYESORE

- 15,1% e nxënësve kanë raportuar se së paku disa nga mësimdhënësit përdorin dhunë fizike ndaj nxënësve të tyre.
- Për më tepër, 34,4% e nxënësve raportuan se të paktën disa nga mësimdhënësit ngacmojnë seksualisht nxënësit dhe 51,4% raportuan se të paktën disa mësimdhënës i ngacmojnë (bullizojn) nxënësit.
- Përveç kësaj, 84,9% e nxënësve nuk kanë psikolog/e të punësuar në shkollë, 39,6% e nxënësve nuk kanë bibliotekë në shkollë dhe 61,3% e nxënësve kanë raportuar se në shkollë nuk ka pjerrina për të hyrë në shkollë nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Për më tepër, vetëm 2,8% e nxënësve raportuan se në shkollë ka banjo të qasëshme për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Vetëm 43,9% e nxënësve thonë se funksionojnë daljet emergjente.
- Vetëm 16,5% e të anketuarve nga Prishtina thonë se banjat e mësimdhënësve janë të njëjtë me banjat e nxënësve.
- 44,3% e nxënësve thonë se klasa është të paktën jo gjithmonë mjaft e ngrohtë në dimër, me 12,7% që deklarojnë se asnjëherë nuk ka qenë ngrohtë në dimër.
- 83% raportuan se nuk ka ujë të ngrohtë në banjo dhe 79,2% e studentëve thanë se nuk ka peceta në banjo.
- 71,2% e të anketuarve raportuan se ata ishin vlerësuar nga një burim i vetëm në të kaluarën me 44,8% të studentëve që deklaruan se ishin vlerësuar vetëm në bazë të sjelljes së tyre ndërsa 39,2% deklaruan se ishin vlerësuar me notë kur nuk ishin prezent dhe 47,2% e nxënësve deklaruan se ishin vlerësuar në një lëndë në bazë të notave në lëndë të tjera në të kaluarën.
- 58,1% e nxënësve kanë gjetur të paktën disa gabime faktike në librat e tyre shkollorë dhe 83,9% kanë gjetur të paktën disa gabime drejtshkrimore në librat e tyre.
- 52,4% e nxënësve raportuan se nuk ka policë të shtrirë për të ngadalësuar shpejtësinë e veturave rreth shkollave dhe 38,2% deklaruan se makinat kalojnë afër shkollës me shpejtësi të madhe.
- Ndërsa, 21,7% thanë se nuk kishte vendkalime për këmbësorë.

H Y E

R J E

HYRJE

Këshilli Rinor Kosovar (KYC) është organizatë jo-qeveritare që aspiron të punojë drejt ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë përmes promovimit të iniciativës, mbështetjes së të rinjve, angazhimit të vajzave dhe djemve në procese vendimmarrëse, fuqizimit të kapaciteteve të tyre, përfaqësimit të zërit rior, promovimit të edukimit të vetë organizuar dhe mbështetjen e zhvillimit të politikave rimore. Të rintjtë, pra, janë motori i organizatës me të cilët ne synojmë të rrisim cilësinë në arsim. Një ndër format kryesore të punës drejt sigurimit të cilësisë së edukimit në vend është angazhimi në krijimin dhe funksionalizimin e këshillave të nxënësve në shkolla dhe mirëmbajtjen e strukturës, e cila përfaqëson nxënësit e shkollave të mesme të larta në Kosovë, Këshillin e Nxënësve të Kosovës.

KYC, në vitin 2005 ka themeluar strukturën më të madhe përfaqësuese të nxënësve të shkollave të mesme të larta – Këshillin e Nxënësve të Kosovës. Përbëhet nga 106 përfaqësues nga 106 shkolla të mesme në 30 komuna të Kosovës. Kjo strukturë kombëtare përfaqëson të gjithë nxënësit e shkollave të mesme, mbron interesat dhe të drejtat e nxënësve dhe bashkëpunon me zyrtarë, prindër, profesorë dhe institucione të tjera arsimore në të mirë të të gjithë sistemit arsimor.

Sipas nenit 23 të Statutit të Këshillit të Nxënësve të Kosovës, anëtarët e Këshillit Drejtues (KD) të KNK-së zgjidhen nga Kuvendi i KNK-së me anë të votimit nga ana e përfaqësuesve të secilës komunë. Kjo zgjedhje zhvillohet në fillim të vitit shkollor, dhe KYC-i vazhdon tutje punën direkt me të përzgjedhurit, ndërsa indirekt me çdo nxënës tjetër në shkollat e mesme të larta të Kosovës. KYC në bashkëpunim me strukturat e lartëpërmendura si dhe me Klubin për Arsim më të Mirë (KAM), ka arritur të publikojë hulumtime e analiza të ndryshme, dhe të organizojë iniciativa avokuese, qysh nga viti 2005. Një prej produkteve me të cilën KYC-i krenohet është edhe raporti mbi qëndrimet dhe/ose perceptimet e Këshillit të Nxënësve të Kosovës rrëth cilësisë së Arsimit në Kosovë.

I pari raport i këtij lloji është publikuar në vitin 2010, i cili ka marrë përbazë perceptimin e nxënësve për të matur cilësinë e arsimit në Kosovë. Ky raport ka qenë nismë e mirë sa i përket rrugës së hulumimit të cilësisë pasi përmes të dhënavë të mbledhura nga nxënësit janë identifikuar shumë sfida. Tëtje, në vitin 2016, të nxitur nga studimi i vitit 2010, KYC u angazhua që të përcaktojë cilësinë në arsim për tri kategoritë kryesore: përbajtja mësimore, procesi dhe mjedisi mësimor. Në këtë raport u përdor metodologji e trefishtë pasi që u përdor pyetësori, intervista dhe analiza ligjore të arsimit parauniversitar për të studiuar cilësinë në arsim me fokus në fushat e lartëpërmendura.

Ky raport tutje ofroi rekomandime drejt iniciativave dhe aktivitetave që duhet ndërmarrë për avancimin në edukim, sipas perspektivës së nxënësve, duke avokuar kështu që nxënësit të konsiderohen partnerë në përpjekjet e përmirësimit të cilësisë në edukim.

Disa nga të dhënat interesante, të rëndësishme dhe alarmante rreth përbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor që dolën nga ky raport (2016) janë si në vijim:

- Tekstet e librave, nuk janë në përputhje me kurrikulen, përbajnjë gabime faktike dhe nuk janë të ri-freskuar me informacione nga zbulimet e reja.
- Ekziston mungesë e librave sidomos për lëndët e shkollave profesionale.
- Ekziston mungesë e laboratoreve dhe kabinetave funksionale në shkolla.
- Nxënësve nuk i'u mundësohet zgjedhja e lëndëve zgjedhore.
- Organizohen kurse private nga mësimdhënësit/et për lëndët që ligjerojnë në shkollë.
- Mungesa e semaforëve, vijave të këmbësorëve, policëve të shtrirë dhe mos-rrethimi i shkollës i bën nxënësit të mos ndihen të sigurtë.
- Ekziston mungesë e infrastrukturës adekuate në shkollë (banka, dritare, dyer etj).
- Shkolla nuk është mjaftueshëm e ngrohtë gjatë dimrit dhe freskët gjatë verës.
- Ekziston mungesë e shkallëve të sigurisë dhe planit të emergjencës në shkollë.
- Ekziston mungesë e qasjes së sigurtë për nxënësit me aftësi të kufizuar.
- Nxënësit paguajnë nga xhepi i tyre për kompani private të sigurimit.
- Në shkollë ka mungesë të ujit, detergjentit për larjen e duarve dhe pecetave.
- Cilësia e ajrit dhe ndriçimi adekuat është shqetësues për nxënësit.
- Ka mungesë të psikologëve në shkollë.

Ligji për arsimin para-universitar (04/L-032), rregullon shumicën e çështjeve të lartpërmendura, por që rëndom gjejnë zbatim, për shkaqe të ndryshme, marrë parasysh të dhënat nga studime e analiza në këtë fushë (Mekolli, 2015; OSBE, 2018; Buçaj, 2018). Për më tepër, puna drejt përmirësimit të gjendjes në këto dimensione ka qenë dhe është vazhdimi i pjesë e strategjive kombëtare për cilësinë në arsim. Për të ilustruar, ndër objektivat e strategjisë afatgjate për shkollat promovuese të shëndetit në Kosovë (2009-2018), krijuar nga Komiteti Ndërministror, kanë qenë: mjedis i shëndetshëm dhe përkrahës nga ana e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve; përkujdesje cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve dhe mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënësve.

Në këtë linjë, edhe strategjia e fundit për arsimin (2007-2017), ka specifikuar objektivat për të arritur kushte më të mira për të gjithë nxënësit. Kjo strategji udhëzon për sigurimin e kushteve të përshtatshme për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit, gjithëpërfshirjen, barazinë, respektimin e diversitetit në arsim, integrimin e të gjitha komuniteteve etnike, krijimin e kushteve për aktivitete fizike dhe sportive, pajisje me mjete konkretizimi në shkolla dhe përdorim i tyre nga mësimdhënësit, e udhëzime në dimensione të tjera.

Përveç raportit të fundit nga KYC, edhe organizata e institucionë tjetra në vend kanë zhvilluar studime drejt matjes së dimensioneve të ndryshme së cilësisë në arsim. Marrë shembull, hulumtimi nga Mekolli (2015) për Institutin Pedagogjik të Kosovës, në hulumtimin për Dhunën dhe Sigurinë në Shkolla, gjeti se sulmet nga qentë endacakë, ngacmimet nga huliganët, aksidentet nga mjetet e komunikacionit janë arsyet kryesore të ndjenjës së pasigurisë në shkollë. Tësia, 60% e nxënësve kanë parë ndonjë nxënës që ka qenë viktimi e dhunës, kërcënimit apo ngacmimit në shkollë. Sa i përket higjenës, sipas raportit të ri-organizimit të shkollave të vitit 2019 në komunën e Kamenicës, 40% e shkollave të nivelit të ulët mësimor nuk kanë mjeshtë pastër, specifisht kanë tualete jo funksionale. Gjersa, me aq njohuri e hulumtim sa kemi bërë nuk ka ndonjë studim tjetër që mat nivelin e higjenës në shkolla. Në anën tjetër në aspektin e përbajtjeve dhe praktikave mësimore, sistemi i arsimit në Kosovë është kritikuar shumë si shkak i rezultateve të ulëta në garën për arsim PISA, duke u rendiur kështu në fund të listës për disa vite radhazi.

Kur flasim për shëndetin mendor dhe shkollat, përgjegjësitë e psikologëve dhe pedagogëve shkollorë janë të rregulluara sipas Udhëzimit Administrativ nr. 34/2014 për funksionimin e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në Shkolla.

Sipas faqes zyrtare të Asociacionit të Psikologëve Shkollorë të Kosovës (APSHK), për 1058 institucionë arsimore në Kosovë, janë të punësuar vetëm 57 psikologë shkollorë dhe 50 pedagogë. Pavarësisht faktit se roli i psikologëve është shumë i rëndësishëm, për shkak të lehtësimit të barrës të mësimive, menaxhimit të presionit social, të shqetësimive mendore përgjatë viteve të adoleshencës, dinamikave që kjo fazë zhvillimore përbandhe nevojës për përkrahje, numri i psikologëve shkollorë të punësuar është shumë i ulët.

Për të ilustruar, Arënliu dhe kolegët (2013), hulumtuan rrëth mendimeve vetëvrasëse dhe kuptuan se janë prevalente ndër adoleshentët Kosovarë. Në anën tjetër, sipas Ukës dhe kolegëve (2021), zhvillimi i aseteve zhvillimore të jashtme, siç janë mbështetja nga të tjerët dhe fuqizimi i nxënësve, luan rol të rëndësishëm në arritjen e lartë akademike.

Përveç faktorëve të lartpërmendur, vështirësitë e edukimit në Kosovë përfshijnë edhe mungesën e infrastrukturës në shkollë, buxhetin për trajnimin e mësimdhënësve, materiale adekuatë të mësimdhënies, mungesën e laboratorëve, numrin e lartë dhe/ose të ulët të nxënësve në shkolla (varësisht prej komunave), e shumë të tjera. Në këtë linjë, Kosova ka rrugë sfiduse drejt përmirësimit të cilësisë në arsim. Prandaj, Këshilli Rinor Kosovar me aktivitetet e tij angazhohet drejt lehtësimit të kësaj rruge, përmes iniciativave të ndryshme lidhur me avancimin në edukim, ndër të cilat është edhe ky rapport hulumtues.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT AKTUAL

Duke pasur parasysh që Këshilli Rinor Kosovar (KYC) avokon që nxënësit të përfshihen si partnerë në përpjekjet për përmirësimin e cilësisë në arsim, një nga praktikat më të mira për përfshirje në këtë qëllim është të kuptohen qëndrimet e nxënësve ndaj tij. Raporti aktual synon të vlerësojë cilësinë në arsim duke u bazuar në perceptimet e nxënësve për përbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor. KYC, gjithashtu synon ta kthejë këtë qasje nga baza në traditë përmes raportimit për situatën aktuale dhe përfshirjes në procesin e vendimmarrjes me institucionet.

Raporti synon të kuptojë problemet dhe shqetësimet kryesore të nxënësve në dimensione të ndryshme, si literatura, lëndët me zgjedhje, vlerësimi dhe metodat e mësimdhënies, përbushja e qëllimeve personale arsimore, laboratorët, zhurmat, siguria e shkollës, higjiena, ndriçimi, biblioteka, shëndeti mendor, pirja e duhanit, dhuna, ushqimi, gjithpërfshirja, përfshirja e prindërve/kujdestarit ligjor dhe aktivitetet jashtëshkollore.

Raportimi i individualizuar i secilës komunë duhet të ofrojë një pasqyrë më të detajuar të perceptimit të nxënësve në nivel lokal, duke ju ofruar komunave mundësinë që të orientojnë politikat e tyre arsimore, duke u bazuar në të dhëna.

METODOLOGJIA

Ky hulumtim ka dizajn sasior pasi ka përdorur pyetësorin si bazën kryesore të matjes së perceptimit të nxënësve për cilësinë në edukim, specifiksht tri dimensione të tij: përbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor. Në kuadër të pyetësorit nxënësit kanë pasur mundësinë të shprehin mendime, gjë që i ka shtuar edhe vlerë cilësore hulumtimit.

Mostrimi i rastësishëm i stratifikuar është përdorur për të mbledhur të dhënat. Kjo do të thotë se komunat janë konsideruar si grupe, dhe në bazë të numrit të nxënësve dhe shkollave në atë vend është bërë shtresimi i popullësisë, me qëllim të tentimit që të mos kemi mbipërfaqësim apo nënpërfaqësim të ndonjë komune. Në shtojcën II bashkëngjitur gjeni numrin e nxënësve të secilës komunë që përfundimisht kanë marrë pjesë në studim.

Për raportet e detajuara për secilën komunë janë mbledhur dhe analizuar të dhënat nga grupi i asaj komune.

MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Grumbullimi i të dhënavës është bërë në periudhën shkurt-mars 2022, në formë fizike dhe virtuale. Në formën fizike, pyetësori është administruar nga nxënës/përfaqësues të Këshillit të Nxënësve të Kosovës (KNK), të cilët përmes telefonit në Google Form, kanë plotësuar pyetësorin gjersa nxënësit e tjerë janë përgjigjur. Duke qenë se përfaqësuesit e Këshillit Drejtues (KD) përfaqësojnë komunën, ata kanë pasur përgjegjësi të monitorojnë përfaqësuesit e nxënësve nga shkollat e tjera në komunën e tyre; nxënës/e përgjegjës/e për mostrën nga një shkollë përkatëse.

Gjithsesi, për shkak të kufizimeve në shkollat ku ka pasur numër të madh të rasteve me Covid-19, në pak raste, grumbullimi i të dhënavës është bërë edhe duke e ndarë pyetësorin me nxënësit e shkollës sipas udhëzimeve të përshkruara më poshtë.

Para fillimit të administrimit, nxënësit përveç që kanë ndjekur një trajnim për administrim të pyetësorit, ata kanë pranuar edhe një video e cila ka shpjeguar hapat që duhet ndjekur për t'iu qasur nxënësve dhe si të elaborojnë pyetjet në rast të ndonjë paqartësie. Gjithashtu, secilit/es administrues/e iu është dërguar numri i mostrës që është i nevojshëm për shkollë dhe komunë. Me qëllim të një mostre me diversitet, administruesit janë udhëzuar gjithashtu që në mostrën e shkollës përkatëse të intervistojnë duke pasur parasysh balancin në gjini, etni, sukses akademik dhe aftësi të kufizuar.

KRIJIMI I INSTRUMENTIT MATËS

Formulimi i pyetësorit për matjen e perceptimit të nxënësve mbi cilësinë në arsim ka kaluar gjithsej tri faza për t'u finalizuar. Faza e parë ka përfshirë nxjerrjen e dimensioneve kryesore nga të gjeturat e raportit mbi cilësinë në arsim, në publikuar nga KYC në vitin 2016, dhe formulimin e deklaratave dhe pyetjeve në këto të gjatura.

Faza e dytë ka përfshirë marrjen e komenteve nga nxënësit e Këshillit Drejtues të Nxënësve. Këta të fundit janë ndarë në grupe dhe kanë ofruar propozime për ndryshime ose shtesa në pyetësor. Në fazën e tretë, janë marrë parasysh komentet, është ristrukturuar pyetësori dhe është bërë konsultimi përsëri me stafin e KYC.

INSTRUMENTI MATËS

Pyetësori gjithsej ka pasur 90 pyetje, dhe ka marrë kohë rreth 30 minuta për t'u administruar. Pyetësori ka përfshirë pyetjet demografike (klasa, gjinia, orientimi seksual, etnia, vendbanimi, nevoja e veçantë) dhe pyetje tjera të ndara në 22 dimensione tjera të ndërlidhura me cilësinë në arsim, specifisht për përbajtjen, procesin dhe mjedisin mësimor. Në tabelen nr.1 gjeni të gjitha dimensionet me pyetjet model për dimensionet që janë trajtuar në kuadër të pyetësorit në fjalë. Tësia, pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të ofrojnë komente shtesë rreth temave dhe/ose pyetësorit.

ASPEKTI ETIK

Dizajni i hulumtimit dhe realizimi i tij është bërë në përputhje me parimet etike për studime, Nxënësve iu është garantuar besueshmëri e plotë e të dhënavë dhe iu është bërë e ditur se mund të largohen nga plotësimi i pyetësorit në rast se nuk ndihen mirë fizikisht, psiqikisht apo nëse për ndonjë arsyje tjetër vendosin të mos marrin pjesë. Tësia, nuk është marrë në asnjë rast emri ose ndonjë e dhënë tjetër identifikuese.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e mbledhura në Google Form, janë bartur në Excel, ku është bërë pastrimi i databazës. Të dhënat janë koduar në Paketën Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS). Rezultatet, interpretimet dhe diskutimi janë bërë në varësi prej të dhënavë të fituara nga pjesëmarrësit.

Nr.	Dimensionet	Pyetje model
1	Përbajtja e librave	“Unë kam vërejtur se tekstet e librave përbajnjë gabime drejtshkrimore”
2	Përdorimi i librave	“Ne përdorim libra për çdo lëndë mësimore”
3	Notimi	“Unë jam notuar në një lëndë në bazë të notave në lëndë të tjera”
4	Praktikat e ligjërimit	“Mësimdhënësit ndajnë klasën në grupe për të punuar për detyra/projekte”
5	Qëllimet personale të edukimit	“Unë mendoj se mësimet në shkollë i kontribuojnë qëllimeve të mia afatgjate në edukim”
6	Higjiena	“Në klasë ka numër të madh të mbeturinave”
7	Ndriçimi dhe klima	“Në shkollë dhe në klasa ka mjaftushëm ndriçim”
8	Pirja e duhanit në shkollë	“Nxënësit pijnë duhan në ambientet e brendshme të shkollës”
9	Perceptimi i sigurisë në shkollë	“Rrugës për në shkollë dhe rreth saj ne rrezikohemi nga qentë endacakë”
10	Dhuna nga mësimdhënësit	“Në shkollë ka mësimdhënës që godasin nxënësit”
11	Dhuna në mes të nxënësve	“Në shkollë nxënësit grinden fizikisht me njëri-tjetrin”
12	Përfshirja e prindërve në shkollë	“Prindërit/kujdestarët janë zë i rëndësishëm në vendimet e shkollës”
13	Lënda zgjedhore	“Unë kam pasur mundësinë të zgjedh lëndën zgjedhore”
14	Laboratoret	“Në shkollën time është funksional...”
15	Biblioteka	“Ne kemi bibliotekë në shkollë”
15.1.	Biblioteka	“Biblioteka në shkollë është e qasshme për të mësuar pas mësimit.”
16	Zhurma	“Zhurma përreth objektit të shkollës dëmton procesin mësimor në klasë”
17	Trafiku afër shkollës	“Afër shkollës ka vija të bardha për kalim të sigurt të rrugës”
18	Shëndeti mendor	“Në shkollë ka psikolog/e të punësuar”
19	Ushqimi	“Kemi bufe në shkollë”
20	Gjithëpërfshirja	“Në shkollë ka pjerrinë për qasje në shkollë për nxënësit ose mësimdhënësit me aftësi të kufizuara”

R E Z

T A T


**ZUL
TET**

REZULTATET SASIORE

Fillimisht, të dhënrat janë analizuar në mënyrë deskriptive me qëllim për të kuptuar gjendjen aktuale.


Në Prishtinë, morën pjesë në pyetësor gjithsej 212 nxënës, nga 14 shkolla të mesme të larta publike. Nga këta nxënës 21,2% (N=45) janë në klasën e dhjetë, 30,7% (N=64) në klasën e njëmbëdhjetë dhe 103 në klasën e dympëdhjetë. 17,5% (N=37) prej tyre janë nga fshati dhe 82,5% (N=175) nga qyteti. Nga nxënësit, 99,1% (N=210) janë shqiptarë, 0,5% (N=1) nxënës është turk dhe 0,5% (N=1) boshnjak.

59,9% (N=127) nga të anketuarit thanë se janë femra, 39,2% (N=83) thanë se janë meshkuj dhe 0,9% (N=2) nxënës thanë se janë të tjerë. 81,1% (N=172) nxënës u përgjigjën se ishin heteroseksualë, 0,5% (N=1) gej, 0,5% (N=1) panseksual, 1,9% (N=4) biseksual, 0,9 (N=2) nxënës u përgjigjën si "tjetër" dhe 15,1% (N=32) zgjodhën që të mos i përgjigjen pyetjes. 95,3% (N=202) nxënës raportuan se nuk kanë aftësi të kufizuara, ndërsa 4,7% (N=10) raportuan se kishin aftësi të kufizuara.




Sa i përket materialit mësimor, duke u nisur nga statistikat e përgjithshme, nuk është për t'u habitur që vetëm 7,1% e nxënësve deklaruan si të pavërtetë që librat kanë gabime drejtshkrimore, 11,3% e nxënësve thanë se kjo është pjesërisht e pavërtetë, 46,7% thanë se kjo është e vërtetë dhe 25,9 e nxënësve thanë se është shumë e vërtetë se librat që përdorin kanë gabime drejtshkrimore, ndërsa 9% e nxënësve thanë se nuk e dinë nëse ka gabime drejtshkrimore në libra. Pastaj, 22,6% e nxënësve që u përgjigjën e gjetën të pavërtetë se ka gabime faktike në librat e tyre, 17% e nxënësve thanë se kjo është pjesërisht e pavërtetë, 30,7% e nxënësve deklaruan këtë si pjesërisht të vërtetë dhe 10,4% e nxënësve e raportuan si shumë të vërtetë se ka gabime faktike në librat që përdorin, ndërsa 19,3% nxënës raportuan se nuk e din nëse ka gabime faktike në libra. 8,5% nxënës thanë se është shumë e pavërtetë që librat kanë informacion të përditësuar, 13,7% thonë se kjo është pjesërisht e pavërtetë, 23,6% të anketuarve e kanë gjetur pjesërisht të vërtetë dhe 45,8% thanë se është shumë e vërtetë që librat që përdorin janë të përditësuar, ndërsa 8,5% e nxënësve nuk e din nëse informacioni në libra është i përditësuar.


Unë kam vërejtur se tekstet e librave përbajnjë gabime drejtshkrimore



Unë kam vërejtur se tekstet e librave përbajnjë gabime faktike




Unë kam vërejtur se tekstet e librave nuk janë të ri-freskuar me informata të reja.




Duke u nisur nga gjetjet e mëparshme, nuk është për t'u habitur që pyetjet e mëtejshme në lidhje me materialin mësimor tregojnë se 19,3% prej nxënësve raportuan se nuk është aspak e vërtetë që kanë libra për çdo lëndë. Përveç kësaj, 14,2% e nxënësve e gjetën këtë të pavërtetë deri diku. Nga ana tjetër, 34% e nxënësve e gjetën të vërtetë deri diku dhe 32,5% shumë të vërtetë që kanë libra për të gjitha lëndët. 13,2% nxënës raportuan se nuk është aspak e vërtetë që përdorin skripta dhe 10,4% e gjetën të pavërtetë deri diku, ndërsa 42,9% e nxënësve e gjetën të vërtetë deri diku dhe 33,5 e nxënësve e gjetën shumë të vërtetë që përdorin skripta në klasë. Gjithashtu 50% nxënës e kanë gjetur shumë të pavërtetë dhe 15,1% të pavërtetë deri diku që përdorin libra që nuk janë në kurrikulë, ndërsa 20,3% nxënës e kanë gjetur deri diku të vërtetë dhe 14,6% të anketuar e kanë gjetur shumë të vërtetë që përdorin libra që nuk janë pjesë e kurrikulës.


Ne përdorim libra pér cdo lëndë mësimore




Ne përdorim skripta pér të mësuar lëndët



Ne përdorim libra të cilat nuk janë pjesë e kurrikulës




Unë kam pasur mundësinë të zgjedh lëndën zgjedhore




Sa i përket sistemit të notimit, 28,8% nxënës janë përgjigjur se nuk janë vlerësuar asnjëherë në bazë të një burimi të vetëm, ndërsa 18,4% të anketuarve thanë se ishin vlerësuar nga një burim i vetëm ndonjëherë, 26,9% se janë vlerësuar shpesh dhe 25,9% nxënës thonë se ata gjithmonë janë vlerësuar me një burim të vetëm. 55,2% e nxënësve raportuan se nuk ishin vlerësuar kurrë sipas sjelljes së tyre dhe 20,8% se ishin vlerësuar ndonjëherë sipas sjelljes së tyre, ndërsa 9% e nxënësve thanë se ishin vlerësuar shpesh në bazë të sjelljes dhe 15,1% që vlerësoheshin gjithmonë në bazë të sjelljes. 60,8% e nxënësve nuk janë notuar asnjëherë pa prezencën e tyre dhe 13,2% nxënës ndonjëherë janë vlerësuar me notë në mungesë ndërsa 12,7% shpesh dhe 13,2% nxënës gjithmonë janë vlerësuar pa prezencën e tyre. Gjithashtu raportohet se 52,8% nxënës nuk janë vlerësuar kurrë në bazë të notave të tjera, dhe 18,9% nxënës ndonjëherë janë vlerësuar në bazë të notave të tjera, ndërsa 17,5% nxënës shpesh dhe 10,8% nxënës gjithmonë janë vlerësuar në bazë të notave të tjera. Përsëri, duke u nisur nga rapporti pér të gjithë Kosovën, kjo nuk është vërtet befasuese dhe i përshtatet të gjeturave të mëparshme.


Unë kam marrë notë duke u vlerësuar vetëm nga një burim (me gojë, shkrim ose aktivitet) dhe jo kombinim




Unë kam marrë notë vetëm në bazë të sjelljes sime gjatë orës së mësimit dhe jo dijes



Unë jam notuar pa prezencën time




Unë jam notuar në një lëndë në bazë të notave në lëndë të tjera




15,6% e nxënësve u shprehën se asnjëherë dhe 30,7% e nxënësve u shprehën se ndonjëherë ju duken të mërzitshme metodat e mësimdhënies në klasë. Ndërsa, 26,9% nxënësve ju duken shpesh të mërzitshme dhe 26,9% e nxënësve thonë se metodat e mësimdhënies janë gjithmonë të mërzitshme. Në kuadër të kësaj, nuk është befasi e madhe që, 32,7% e nxënësve thonë se videot nuk përdoren kurrë në klasë, ndërsa 37,2% nxënës thonë se përdoren ndonjëherë dhe 29,6% kanë deklaruar se përdoren shpesh. Vetëm 0,5% nxënës tha se ato gjithmonë përdoren. 20,8% nxënës u përgjigjnë se mësimdhënësit kurrë nuk përdorin mjete konkretizuese (ilustruse) për të shpjeguar mësimet, 32,5% thanë se ndonjëherë përdoren mjetet konkretizuese (ilustruse). Ndërsa, 25% thonë se mësimdhënësit shpesh, dhe 21,7% thonë se përdorin gjithmonë mjete konkretizuese (ilustruse) për të shpjeguar mësimet. Sipas 13,2% të nxënësve, mësimdhënësit kurrë, ose sipas 34% ndonjëherë i kushtojnë vëmendje interaktivitetit. Nga ana tjetër, 34,9% nxënës thonë se shpesh, dhe 17,9% nxënës thonë se mësimdhënësit gjithmonë i kushtojnë vëmendje interaktivitetit në klasë. Sipas 36,8% të nxënësve, mësimdhënësit nuk ndajnë kurrë informacione personale në klasë, 38,7% thonë se ndonjëherë e ndajnë, ndërsa 18,4% thanë se ndajnë shpesh informacione personale dhe sipas 6,1% të nxënësve, mësimdhënësit gjithmonë ndajnë informacione personale në klasë.


Unë mendoj se mënyra e ligjërimit të lëndëve në shumicën e rasteve është e mërzitshme (boring).




Mësimdhënësit gjatë ligjërimit shpesh përdorin video për të ilustruar më mirë mësimin.




Mësimdhënësit përdorin mjete konkretizuese për spjegimin e lëndës




Mësimdhënësit i kushtojnë rëndësi interaktivitetit përmes diskutimeve.



Mësimdhënësit kalojnë më shumë se gjysmën e orës duke ndarë informata personale dhe jo-relevante me temën.




Neve na u është diktuar mësimi të paktën njëherë nga mësimdhënësit ose nga dikush që ata kanë përcaktuar.




Sa i përket burimeve të tjera të tē nxënësve thanë se mësimdhënësit nuk shpérndajnë kurrë shënimë në klasë, 38,2% thonë se ndonjëherë shpérndajnë, ndërsa 26,4% thonë se bëjnë shpesh dhe 11,3% thonë se mësimdhënësit gjithmonë shpérndajnë shënimë në klasë. Për më tepër, 21,7% e nxënësve thanë se klasat nuk ndahen kurrë në grupe, 34,9 thanë se ndonjëherë ndahen, 31,1% thonë se shpesh ndahen në grupe dhe sipas 12,3% të nxënësve, klasat ndahen gjithmonë në grupe.

Për më tepër, 52,4% e nxënësve thonë se mësimdhënësit e tyre nuk mbajnë kurrë kurse private. 20,3% thanë se ndonjëherë mbajnë, 8,5% thonë se mësimdhënësit e tyre shpesh mbajnë kurse private dhe 18,9% e nxënësve thanë se mësimdhënësit e tyre mbajnë gjithmonë kurse private, gjë që është problematike, sepse janë ata që do t'i vlerësojnë në shkollë!


Mësimdhënësit japid vetëm shënimë



Mësimdhënësit ndajnë klasën në grupe për të punuar në detyra/projekte




Ne kemi mësimdhënës të cilët mbajnë kurse private për lëndën që ligjerojnë në shkollë.




Sa i përket fytshmërisë së mësimeve të perceptuara nga nxënësit, kemi disa gjetje shumë pozitive siç mund të shihet. 5,2% e nxënësve të përgjigjur thanë se është aspak e vërtetë që mësimet në shkollë i kontribuojnë qëllimeve të tyre afatgjata në edukim, ndërsa 16% e gjetën atë mohim të pavërtetë deri diku. 34,9% thanë se është deri diku e vërtetë dhe 43,9% thanë se është shumë e vërtetë që mësimet në shkollë i kontribuojnë qëllimeve të tyre afatgjata në edukim. Për më tepër, mësimet në shkollë janë gjetur të dobishme nga 49,5% e nxënësve. Ndërsa, 33,5% nxënës e kanë gjetur atë pohim deri diku të vërtetë dhe 13,7% nxënës deri diku të pavërtetë. Përkundrazi, 3,3% nxënës e gjetën pohimin si aspak të pavërtetë. 9,4% e nxënësve nuk e shohin se si mësimet nga shkolla mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve jashtë shkollës. 24,5% e gjetën deri diku të pavërtetë pohimin se mësimet mund të ishin të dobishme jashtë shkollës, ndërsa 29,2% e gjetën atë deri diku të vërtetë. 36,8% e gjetën këtë pohim shumë të vërtetë. Nga ana tjeter, 19,3% e nxënësve e shohin si shumë të pavërtetë pohimin se mësimet i kanë përgatitur për tregun e punës, ndërsa 24,1% nxënës e shohin këtë pohim deri diku të pavërtetë dhe 24,5% e konsiderojnë deri diku të vërtetë ndërsa 32,1% e konsiderojnë shumë të vërtetë pohimin se mësimet i kanë përgatitur për tregun e punës.


Unë mendoj se mësimet në shkollë i kontribuojnë qëllimeve të miaj afatgjata në edukim.




Unë mendoj se mësimet në shkollë janë të dobishme.



Unë mendoj se mësimet në shkollë më ofrojnë mundësi të zgjedh probleme në të ardhmen.




Unë mendoj se programi i shkollës më ka përgaditur shumë për tregun e punës




39,6% e nxënësve raportuan se nuk kishin bibliotekë në shkollën e tyre dhe 60,4% raportuan se kishin një bibliotekë në shkollë. Nga nxënësit që raportuan se kishin një bibliotekë në shkollë, 67,2% raportuan se biblioteka kishte një bibliotekist/e, ndërsa 32,8% raportuan se nuk kishte. Deklarata se biblioteka ka një sasi të mjaftueshme librash është gjetur e pavërtetë nga 7% e këtyre nxënësve, ndërsa 19,5% prej tyre e kanë gjetur këtë pjesërisht të pavërtetë dhe 38,3% e nxënësve e gjetën pjesërisht të vërtetë ndërsa 35,2% nxënës e gjetën shumë të vërtetë se biblioteka ka një sasi të mjaftueshme librash.

18% e nxënësve e kanë gjetur shumë të vërtetë që biblioteka është e qasëshme për të mësuar, 19,5% e kanë gjetur këtë pjesërisht të vërtetë, 16,4% e kanë gjetur pjesërisht të pavërtetë dhe 46,1% e nxënësve e kanë gjetur të pavërtetë se biblioteka është e qasëshme për të mësuar. 11,7% e nxënësve e gjetën të pavërtetë që librat në bibliotekë përputhen me mësimet në shkollë, ndërsa 16,4% nxënës e gjetën këtë pohim deri diku të pavërtetë. 40,6% e gjetën pohimin deri diku të vërtetë dhe 31,3% e nxënësve e gjetën shumë të vërtetë që librat në bibliotekë përputhen me mësimet në shkollë.


Biblioteka ka bibliotekist/e




Ne kemi bibliotekë në shkollë




Biblioteka në shkollë ka numër të mjaftueshëm të librave



Biblioteka në shkollë është e qasshme për të mësuar pas mësimit.




Librat në bibliotekë përkijnë me mësimet/moshën/nivelin tonë akademik




Sa i përket zhurmës në shkollë, 32,5% nxënës raportuan se nuk ka asnjëherë zhurmë rreth shkollës që e dëmton procesin mësimor. Ndërsa, 25,9% nxënës thanë se ndonjëherë ka zhurmë, 22,6% nxënës thanë se kishte shpesh dhe, 18,9% nxënës thanë se kishte gjithmonë zhurmë rreth shkollës që e dëmton procesin mësimor. 25,9% e nxënësve thonë se mësimdhënësit nuk dështojnë kurrë në menaxhimin e zhurmës në klasë, ndërsa 33% thonë se ndonjëherë ata dështojnë, dhe 29,7% shpesh nuk arrijnë të menaxhojnë zhurmën në klasë dhe 11,3% nxënës thonë se mësimdhënësit gjithmonë dështojnë të menaxhojnë zhurmën në klasë. 3,8% e nxënësve thanë se mësimdhënësit ishin gjithmonë burimi i zhurmës në klasë dhe, 9,4% nxënës që thanë se ata ishin shpesh burim i zhurmës. 31,6% e nxënësve thonë se ndonjëherë kjo është e vërtetë, ndërsa 55,2% nxënës thanë se kjo nuk ishte kurrë e vërtetë. Nxënësit shihen gjithmonë si burim i zhurmës në klasë nga 52,8% e nxënësve, shpesh nga 25,5%, ndonjëherë nga 16% nxënës dhe asnjëherë nga 5,7% nxënës.


Zhurma përreth objektit të shkollës dëmton procesin mësimor në klasë




Mësimdhënësit nuk arrijnë të menaxhojnë zhurmën në klasë



Mësimdhënësit janë shkaktarë të zhurmës në klasë




Nxënësit janë shkaktarë të zhurmës në klasë




Duke u futur më thellë në temën e çështjeve infrastrukturore dhe si rrjedhojë të sigurisë në trafik gjatë rrugës për në shkollë dhe mbrota; 47,6% e nxënësve u përgjigjën se ka pengesa shpejtësie rrëth shkollës ndërsa 52,4% thanë se nuk ka. 78,3% nxënës raportuan se kishte vija të bardha për kalim të sigurt të këmbësorëve rrëth shkollës, ndërsa 21,7% deklaruan se nuk kishte. Kështu që nuk është çudi që 61,8% nga nxënësit raportuan se makinat kalojnë në afërsi të shkollave me shpejtësi të lartë dhe, 38,2% nxënës që thonë se kjo nuk është e vërtetë.


Afër shkollës ka policë të shtrirë (pengesa për qëllim të ngadalësimit të shpejtësisë)



Afër shkollës ka vija të bardha për kalim të sigurtë të rrugës




Afër shkollës kalojnë vetura me shpejtësi të lartë që rrezikojnë mirëqenien tonë




Çështje të tjera infrastrukturore të fokusuara në vetë objektin shkollor janë po ashtu shqetësuese. Sipas 17% të nxënësve, në shkolla ka ujë të ngrohtë. 83% thonë se nuk është kështu. Për më tepër, 20,8% e nxënësve thonë se ka pecata në banjot e shkollës, ndërsa 79,2% nxënës raportuan se kjo nuk është e vërtetë. Përkundrazi, 72,6% nxënës raportojnë se banjot e shkollës janë higjenike dhe, 27,4% nxënës që thonë se banjot nuk janë higjenike.

Sipas 34% të nxënësve, në shkollë nuk ka asnijëherë ndonjë erë të pakëndshme, ndërsa 25% nxënës thonë se ndonjëherë ka dhe 21,7% thonë se ka shpesh erë të pa këndshme në shkollë, ndërsa 19,3 nxënës e shohin këtë si diqka që ndodh gjithmonë. Po ashtu, 34% e nxënësve madje deklarojnë se ajri në shkollë është gjithmonë e papastër. 28,8% thonë se është shpesh i papastër, 27,4% thonë se është ndonjëherë dhe, vetëm 9,9% thonë se ajri nuk është kurrë i papastër.


Në banjot e shkollës ka peceta




Në banjot e shkollës ka detergjent për larjen e duarve




Në shkollë vie një erë jo e këndshme



Në shkollë ajri është i pastër




Në banjot e shkollës ka ujë të ngrohtë




Duke u zhvendosur nga aspektet strukturore të objektit shkollor drejt mirëmbajtjes së shkollave, 73,6% e nxënësve deklaruani se muret nuk janë asnijëherë të lagura apo të mykura, ndërsa 17,5% deklaruani se muret ndonjëherë janë të lagura dhe të mykura. 5,7% thonë se muret janë shpesh të lagura dhe të mykura dhe 3,3% madje thonë se kjo është gjithmonë e vërtetë. Më tej pohimi se sasi të mëdha plehrash gjenden në shkollë është gjetur e pavërtetë nga 50,5% e nxënësve, e vërtetë deri diku nga 25%, shpesh e vërtetë nga 16,5% dhe gjithmonë e vërtetë me 8%. Vetë nxënësit nuk përfshihen asnijëherë në detyrat e mirëmbajtjes sipas 9% të nxënësve, sipas 25,9% ndonjëherë janë të përfshirë, 25% madje thonë se shpesh janë të përfshirë dhe 40,1% deklarojnë se bëjnë gjithmonë detyra për mirëmbajtje të shkollës. Për punëtorët e mirëmbajtjes, nga nxënësit thuhet se bëjnë gjithmonë një punë të mirë nga 58% e nxënëxve, shpesh nga 23,6%, ndonjëherë nga 13,7% dhe asnijëher nga 4,7% e nxënëxve. Banjot e mësimdhënësve shihen si gjithmonë më të pajisura dhe më të pastra nga 54,2% e nxënësve. 16,5% nxënës thonë se shpesh janë më të pastërtë dhe më të pajisura dhe 12,7% thonë se janë ndonjëherë. 16,5% thonë se kjo nuk është anjëher e vërtetë.


Ka lagështi në klasë tek muret (myk)




Në klasë ka numër të madh të mbeturinave




Nxënësit mirëmbajnë klasën (gjuajnë mbeturinat në shportë)



Mirëmbajtësit në shkollë kryejnë punën ashtu siç duhet




Banjot e mësimdhënësve janë më të pastërtë dhe pajisura se të nxënësve




Pohimi se në klasa ka ndriçim të mjaftueshëm është shumë i vërtetë nga 71,2% e nxënësve. 16% e konsiderojnë këtë të vërtetë deri diku me 8,5% që thonë se kjo është e pavërtetë deri diku dhe 4,2% e gjejnë krejtësisht të pavërtetë. Përveç kësaj, 55,7% e nxënësve e shohin si shumë të vërtetë që shkolla ka ngrohje të mjaftueshme gjatë dimrit me 21,7% nxënës që thonë se kjo është deri diku e vërtetë dhe 9,9% që thonë se kjo është deri diku e pavërtetë. 12,7% nxënës madje e konsiderojnë shumë të pavërtetë faktin se shkolla ka ngrohje të mjaftueshme dimrit. 15,1% nxënës e konsiderojnë si aspak të vërtetë se shkolla është mjaftueshëm e freskët verës dhe 16,5% nxënës thonë se kjo është e pavërtetë deri diku. 28,3% e konsiderojnë të vërtetë deri diku dhe 40,1% nxënës e konsiderojnë shumë të vërtetë që shkolla është mjaftueshëm freskët verës. Tuttje, 41% të nxënësve deklaruan se nxënësit nuk pinë kurrë duhan në shkollë. 16,5% nxënës deklaruan se kjo ndodh ndonjëherë dhe 13,2% u përgjigjën se kjo ndodh herë pas here, ndërsa 9,4% thonë se kjo është një dukuri e shpeshtë dhe 19,8% nga nxënësit madje deklarojnë se kjo ndodh gjithmonë. Në anën tjetër, raportohet se mësimdhënësit kurrë nuk pinë duhan në shkollë nga 61,8% e nxënësve, ndonjëherë pinë duhan në shkollë nga 9,4%, herë pas here pinë duhan në shkollë nga 7,5%, shpesh pinë duhan në shkollë nga 7,1% dhe 14,2% e nxënësve deklaruan se mësimdhënësit gjithmonë pinë duhan në shkollë.

Për më tepër, punëtorët e mirëmbajtjes raportohen të kenë pirë duhan gjithmonë në shkollë nga 11,3% e nxënësve. 5,2% nxënës thonë se kjo ndodh shpesh dhe 12,7% e nxënësve thonë se kjo ndodhë herë pas here. 14,2% nxënës thonë se kjo ndodh ndonjëherë, dhe 56,6% e nxënësve thonë se punëtorët e mirëmbajtjes nuk pinë kurrë duhan në shkollë.


Në shkollë dhe në klasa ka mjaftushëm ndriqim




Në shkollë është ngrohtë mjaftueshëm dimrit




Në shkollë është freskët mjaftueshëm verës




Nxënësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës



Mësimdhënësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës




Punëtorët teknikë & mirëmbajtësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës




Për të vazhduar tutje me objektin shkollor, 13,7% e nxënësve e shohin si aspak të vërtetë që tavolinat dhe karrigjet janë në gjendje të mirë. 17,9% nxënës e konsiderojnë atë si të pavërtetë deri diku dhe 40,6% nxënës e konsiderojnë si deri diku të vërtetë. 27,8% nxënës e konsiderojnë si të vërtetë që tavolinat dhe karrigjet janë në gjendje të mirë. 43,9% thonë se shkolla ka dalje emergjente funksionale, ndërsa 56,1% e nxënësve thonë se kjo nuk është e vërtetë. Nga ana tjetër, 97,2% e nxënësve thonë se shkolla ka rrrethoja, ndërsa vetëm 2,8% thonë se kjo është e pavërtetë. Për më tepër, 60,4% e nxënësve thonë se kanë roje sigurie në shkollë, ndërsa 39,6% nxënës thonë se nuk kanë. Nga ata nxënës që thonë se kanë roje sigurie, 39,4% e nxënësve thonë se paguajnë për rojet e sigurisë dhe 60,6% thonë se nuk paguajnë nga xhepi i tyre.


Bankat, karriget dhe dyert në shkollë janë në gjendje të rregullt




Në shkollë ka shkallë emergjente funksionale




Shkolla ime është e rrrethuar (ka rrrehojë)



Ne kemi roje sigurimi në shkollë




(Nëse ka sigurim në shkollë). Unë paguaj për rojet e sigurimit në shkollë




Ndër qëllimet parësore të çdo institucioni që merret me të rinjtë duhet të jetë t'i mbajë ata të sigurt në mjedisin që ata ofrojnë. Në këtë drejtim kemi rezultate befasuese. 19,3% nxënës e konsiderojnë shumë të vërtetë që shkolla është e sigurt nga tërmeti. 43,4% nxënës e konsiderojnë atë deri diku të vërtetë ndërsa 21,7% e nxënësve e konsiderojnë deri diku të pavërtetë. 15,6% e nxënësve e shohin si aspak të vërtetë pohimin se shkolla është e sigurt nga tërmetet. Përveç kësaj, 36,8% nxënës mendojnë se nuk është e vërtetë që mund të hyjnë nxënës nga shkollat e tjera në shkollën e tyre, 22,6% thonë se kjo është pjesërisht e pavërtetë. 26,9% nxënës mendojnë se është deri diku e vërtetë që minden dhe 13,7% nxënës mendojnë se është shumë e vërtetë. 20,8% nxënës janë përgjigjur se kontrolllet nga policia po ndodhin, ndërsa 19,3% thonë se kjo është pjesërisht e vërtetë. 25% thonë se kjo është pjesërisht e pavërtetë dhe 34,9% e nxënësve thonë se është aspak e vërtet që ka kontrollime nga policia. Megjithatë, 40,6% nxënës thonë se është shumë e pavërtetë që ata kanë qasje të lehtë në lëndë narkotike në shkollë dhe/ose rrëthninë afër. Ndërsa, 17,9% nxënës thonë se kjo është deri diku e vërtetë. 20,3% nxënës thonë se është e vërtetë që kanë qasje të lehtë në lëndë narkotike në shkollë dhe/ose rrëthninë afër.

Për më tepër, 25% nxënës thonë se është shumë e vërtetë që rrugës për në shkollë dhe rrith saj rrezikohen nga qentë endacakë. 19,3% nxënës thonë se kjo është deri diku e vërtetë dhe 23,1% thonë se kjo është deri diku e pavërtetë, ndërsa 32,5% nxënës thonë se kjo nuk është aspak e vërtetë. 84,9% nxënës raportuan se nuk ka asnjë mësimdhënës që godet nxënësit, ndërsa 11,3% nxënës thonë se pak mësimdhënës godasin nxënësit. 2,8% raportuan se disa mësimdhënës e bëjnë këtë dhe 0,9% nxënës thonë se shumë mësimdhënës godasin nxënësit. Përveç kësaj, 65,6% nxënës thonë se nuk ka mësimdhënës që ngacmojnë seksualisht nxënësit, ndërsa 24,1% nxënës thonë se pak mësimdhënës e bëjnë këtë. Ende, 6,6% nxënës thonë se disa mësimdhënës ngacmojnë dhe 3,8% thonë se shumë mësimdhënës ngacmojnë sekusualisht nxënësit. Gjithashtu 48,6% nxënës thonë se asnjë mësimdhënës nuk i ngacmon(bullizon) nxënësit ndërsa 24,1% nxënës thonë se pak mësimdhënës e bëjnë këtë. 20,3% e nxënës madje deklaruan se disa mësimdhënës ngacmojnë (bullizojnë) dhe 9,9% thonë se shumë mësimdhënës ngacmojnë (bullizojnë) nxënësit. Sipas 63,7% nxënësve, në shkollë nuk ndodhin asnjëher përleshje mes nxënësve, ndërsa 24,5% nxënës raportojnë se kjo ndodh një herë deri në dy herë në javë dhe 6,1% nxënës raportojnë se përleshjet mes nxënësve ndodhin dy deri në tre herë në javë, ndërsa 2,4% thonë se kjo ndodh tre deri në katër herë në javë. Madje 3,3% e nxënësve thonë se përleshjet mes nxënësve ndodhin më shumë se pesë herë në javë. 20,3% nxënës raportojnë se ngacmimi (bullizmi) mes nxënësve nuk ndodh asnjëher, ndërsa 38,2% thonë se kjo ndodh ndonjëherë, dhe 25,5% nxënës thonë se kjo ndodh shpesh. 16% nxënës thonë se bullizmi mes nxënësve ndodh gjithmonë. 46,7% nxënës thonë se nxënësit nuk ngacmojnë currë seksualisht njëri-tjetrin, ndërsa 29,7% nxënës thonë se ndonjëherë ngacmojnë njëri-tjetrin. Madje 17% nxënës thonë se kjo ndodh shpesh dhe 6,6% nxënës thonë se ky është gjithmonë problem.


Unë mendoj se do të mund të shpëtoja nëse gjatë kohës që jam në shkollë do të ndodhë ndonjë emergjencë si zjarr a...




Në shkollën time lehtazi mund të kenë qasje nxënësit e shkollave tjera




Brenda shkollës ka kontrolla të rregullta nga policë civilë ose policë të thjeshtë




Unë mendoj se është e lehtë qasja në substancë narkotike, në shkollë dhe/ose rrith saj




Rrugës për në shkollë dhe rreth saj ne rrezikohemi nga qentë endacakë




Në shkollë ka mësimdhënës që ngacmojnë seksualisht nxënësit




Në shkollë ka mësimdhënës që godasin nxënësit




Në shkollë ka mësimdhënës që ngacmojnë (bullizojnë) nxënësit




Në shkollë nxënësit grinden fizikisht me njëri tjetrin



Në shkollë ka nxënës që ngacmohen (bullizohen) nga nxënësit e tjere




Në shkollë ka nxënës që ngacmojnë seksualisht nxënësit e tjere




Në aspektin e shëndetit mendor, ishte e nevojshme përfshirja e pyetjeve përmështetjen psikologjike në shkolla, veçanërisht për të parë nëse korniza ligjore aktuale është e zbatueshme. 15.1% nxënës thonë se në shkollën e tyre ka psikolog, ndërsa 84.9% nxënës thonë se nuk ka. 48.5% nxënës thonë se nuk është e aspak e vërtetë se do t'i besonin psikologut të tyre të shkollës, ndërsa 15.2% nxënës të tjera thonë se është deri diku e pavërtetë se do t'i besonin dhe 18.2% të tjera thanë se është deri diku e vërtetë se do t'i besonin. 18.2% nxënës deklaruan se është shumë e vërtetë se do t'i besonin psikologut/es në shkollën e tyre. 48.5% nxënës thanë se ishin konsultuar tashmë me një psikolog dhe 51.5% thanë se jo. 3% e nxënësve thanë se mësimdhënësit konsultohen me psikologët dhe 33.3% nxënës thonë se nuk është e vërtetë. 6.6% nxënës thonë se është e pavërtetë se ndihen emocionalisht mirë në shkollë me 10.4% nxënës që thonë se kjo është deri diku e pavërtetë dhe 35.4% nxënës thonë se herë pas here ndihen mirë emocionalisht dhe herë pas here jo, ndërsa 19.8% nxënës thonë se është e vërtetë deri diku se ndihen mirë emocionalisht në shkollë dhe 27.8% nxënës thonë se ndjehen mirë gjithmonë.

49.5% nxënës deklaruan se asnjëher nuk janë fyer/ofenduar nga mësimdhënësit e tyre. 14.6% nxënës thonë se ndonjëherë ofendohen nga mësimdhënësit, ndërsa 11.8% nxënës thonë se herë pas here ofendohen nga mësimdhënësit. 9.4% nxënës raportojnë se shpeshherë ofendohen nga mësimdhënësit dhe 14.6% nxënës thonë se ofendohen gjithmonë me fjalë të këqija.


Ofendohem nga mësimdhënësit (p.sh me fjalë fyese si: budalla, idiot)




Mësimdhënësit konsultohen me psikolog/en e shkollës




Unë i do i besoja (besoj) psikologut/es së shkollës (për ndjenjat dhe mendimet e mijë)




Unë ndihem mirë emocionalisht kur jam në shkollë



Unë jam konsultuar të paktën njëherë psikologun/en e shkollës




Në shkollë ka psiklog/e të punësuar




78.8% nxënës kanë raportuar se në shkollën e tyre nuk ka bufe, ndërsa 21.2% kanë thënë se kanë. Megjithatë 82.5% nxënës thanë se u lejohet të sjellin ushqime dhe pijen nga jashtë shkollës. 17.5% nxënës thanë se nuk u lejohet ushqimi dhe pijet nga jashtë. 38.7% nxënës thanë se në shkollë ka pjerrinë për qasjen e nxënësve ose mësimdhënësve, ndërsa 61.3% nxënës thanë se nuk ka pjerrina në shkollë. Për më tepër, vetëm 2.8% nxënës thanë se ka banjo të qasëshme për nxënësit me aftësi të kufizuar në shkollë, ndërsa 97.2% nxënës raportuan se nuk kishte asnjë.


Kemi bufe në shkollë




Lejohen pijet dhe ushqimet nga jashtë brenda shkollës.




Nxënësit që i përkasin komuniteteve pakicë përfshihen në aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore



Në shkollë ka pjerrinë për qasje në shkollë për nxënësit ose mësimdhënësit me aftësi të kufizuara




Në shkollë ka banjo të veçantë për nxënësit me aftësi të kufizuara




13.2% nxënës raportuan se prindërit/kujdestarët ligjorë nuk luajnë asnijëher rol të rëndësishëm në vendimmarjet e shkollës. 34% nxënës deklaruan se ndonjëherë luajnë rol në vendimmarje. 22.6% nxënës deklaruan se ata shpesh luajnë rol dhe 30.2% nxënës deklaruan se prindërit/kujdestarët ligjorë luajnë gjithmonë rol në vendimmarje. 1.9% nxënës thanë se mësuesit nuk janë asnijëherë në kontakt me prindërit/kujdestarët ligjorë, ndërsa 18.4% nxënës thanë se ndonjëherë janë në kontakt. 20.8% nxënës thonë se janë shpesh në kontakt dhe 54.2% nxënës thonë se janë gjithmonë në kontakt, ndërsa 4.7% nxënës nuk e dinë nëse janë në kontakt apo jo. 10.8% të anketuar deklaruan se asnijëherë nuk kan mundësi për t'u përfshirë në aktivitete jashtë shkolllore, ndërsa 19.8% deklaruan se ndonjëherë minden. 21.7% thanë se kjo është shpesh e vërtetë dhe 35.4% thanë se kjo është gjithmonë e vërtetë, ndërsa 12.3% u përgjigjën se nuk e dinë.


Prindërit/kujdestarët janë zë i rëndësishëm në vendimet e shkollës.




Mësimdhënësit janë në kontakt me prindërit/k...




Në shkollën time ekziston mundësia e angazhimit në aktivitete jashtë shkollorë (p.sh klub i debatit, klubi i artit...)



Numri i laboratorëve në shkollë



Numri i laboratorëve funksional



REZULTATET CILËSORE

Pavarësisht se ky nuk ishte qëllimi aktual i pyetësorit dhe studimit, nxënësit patën mundësinë të shprehin shqetësime shtesë në seksionin e komenteve dhe duket e drejtë që ato të mblidhen në mënyrë specifike për secilën komunë, në mënyrë që të jetë i mundur një kuptim më i gjërë i çështjeve me të cilat përballen nxënësit. Së pari, kishte ankesa se nxënësit nuk kishin kohë të mjaftueshme për të pushuar dhe se dy teste në të njëjtën ditë janë të tepërtë për disa nxënës. Gjithashtu, nxënësit u ankuan se shkolla është shumë e ftohtë në dimër dhe se në shkolla ka shumë pak dyer të instaluar dhe shumë prej tyre janë të thyera. Gjithashtu stafi i shkollës u raportua si i pasjellshëm dhe agresiv. Shumë nxënës raportuan se përdorimi i telefonit është i ndaluar në klasë.

Disa nxënës shprehën ndjenjën se kurrikula nuk merret seriozisht dhe se nuk ka një nxitje të vërtetë për të mësuar dhe nxënës të tjerë u shprehën se ata mendojnë, se ka shumë pak nota dhe vlerësime të drejta në shkollë dhe se duhet shumë punë në këtë aspekt. Madje, disa nxënës thanë se zemërimi (nervoza) e mësimdhënësve i pengon ata të mësojnë dhe se kjo ndikon negativisht në frikën e tyre nga shkolla.

Disa nxënës kërkuan që kompjuterët në shkollë të riparohen dhe të funksionalizohet web-faqja e shkollës. Një vërejtje shtesë ishte se kompjuterët funksionalë mund të jenë një tjetër gjë për t'u kërkuar në pyetësor, njësoj si kutitë e ankesave dhe rekomandimeve për studentët. Gjithashtu duhet të përmirësohet mirëmbajtja e tualeteve, për shembull, duke shtuar peceta të reja çdo javë. Një tjetër nxënëse tha se ambienti për praktikë profesionale nuk është në gjendje të mirë. Mjedisi shkollar humbet mundësi dhe aktivitete që nxënësit të angazhohen dhe ta bëjnë më të lehtë ngritjen e zërit të tyre. Gjithashtu, disa nxënës mendojnë se të drejtat e nxënësve nuk respektohen nga mësimdhënësit. Ngacmimet seksuale jo vetëm nga mësimdhënësit, por edhe nga Këshilli Drejtues dhe drejtorët janë raportuar nga nxënësit.

D I S H
T I N

KU

M

DISKUTIM

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte matja e cilësisë në arsim përmes perceptimeve të nxënësve për përbajtjen, procesin dhe mjeshterinë mësimore. Objektiva e parë ishte krijimi i një pyetësori matës së perceptimit të cilësisë në arsim nga ana e nxënësve të shkollave të mesme të larta. Instrumenti i përdorur, sipas komenteve nga nxënësit ka treguar të jetë mjaft gjithëpërfshirës për matjen e perceptimit të nxënësve. Pra, është hap i mirë drejt krijimit të një modeli i cili mund të kthehet në standard të matjes së kësaj perspektive. Gjithsesi, sipas rekomandimeve nga nxënësit (të specifikuara në pjesën e kufizimeve) duhet të shtohen dhe modifikohen disa dimensione, dhe instrumenti duhet të marrë një trajtë të matjes që në të ardhmen të matet vlefshmëria statistikore e tij. Tutje objektivi i dytë, ishte pasqyrimi i gjendjes në arsim në dimensionet e lartpërmendura. Hulumtimet e mëparshme të kryera nga KYC, organizata e institucioneve të tjera, shpesh kanë raportuar mospërmbushje të qëllimeve të strategjive, ligjeve e standardeve për arsimin para-universitar, në dimensione të ndryshme si: siguria, infrastruktura në shkollë, përbajtja e mësimive, ligjërimi, dhuna në shkolla e shumë të tjera. Në këtë linjë qëndrojnë edhe të gjeturat e këtij reporti hulumtues.

PROCESI MËSIMOR

Mbi gjysma e nxënësve (52,8%) raportuan se ata vlerësohen gjithmonë ose shpesh në bazë të një burimi të vetëm. Kjo bie ndesh drejtpërdrejt me Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Nxënësve (UA nr. 08/2016, Neni 3), pasi mësimdhënësit udhëzohen që të përdorin vlerësimin e vazdueshëm, nga disa burime, por edhe atë përfundimtar për të arritur një notë më objektive. Rreth një e katërtë (24,1%) e nxënësve thanë se shpesh ose gjithmonë vlerësohen në bazë të sjelljes afatgjatë në klasë dhe gjithashtu një e katërtë e studentëve (25,9%) deklaruan se shpesh ose gjithmonë vlerësohen në mungesë. Madje më shumë se një e katërtë e nxënësve (28,3%) deklaruan se ishin vlerësuar në bazë të notave nga lëndët e tjera.

Mbi një e treta e nxënësve (36,8%) thonë se mënyrat e mësimdhënies janë shpesh të mërzitshme. Mund të ketë një korrelacion midis kësaj dhe faktit që më pak se një e treta e nxënësve (30,1%) kanë deklaruar se videot përdoren shpesh ose gjithmonë për mësimdhënie. Megjithatë, pothuajse gjysma e të anketuarve (46,7%) deklaruan se mjetet konkretizuese përdoren shpesh ose gjithmonë nga mësuesit. Dhe madje më shumë se gjysma e nxënësve (52,8%) deklaruan se interaktiviteti është shpesh ose gjithmonë i rëndësishëm për mësuesit. Ndërsa nën gjysma e nxënësve (43,4%) thonë se klasat ndahen në grupe kur punojnë në detyra apo projekte. Megjithatë, vetëm pak më shumë se një e katërtë e nxënësve (27,4%) deklaruan se kanë mësues që mbajnë kurse private për të njëjtën lëndë që ata jepin në shkollë.

MJEDISI MËSIMOR

Shëndeti dhe mirëqenia e nxënësve duhet të jetë një nga priorititetet kryesore, por fakti që 83% e nxënësve të përgjigjur deklaruan se nuk kishin ujë të ngrohtë në banjë dhe 79,2% raportuan mungesë pecetash në banjë dhe 27,4 % raportimi i standardeve johigjenike në banja tregojnë se nuk është kështu. 24,5% e nxënësve raportojnë se shpesh ose gjithmonë ka një sasi të madhe mbeturinash në shkollë dhe 42,4% e nxënësve raportojnë se nxënësit pinë duhan në shkollë herë pas here, shpesh ose gjithmonë, ndërsa e njëjtë gjë thuhet për mësimdhënësit nga 28,8% e të anketuarve dhe për punëtorët e mirëmbajtjes nga 29,2%. Për më tepër, 41,5% e nxënësve e shohin të paktën deri diku të vërtetë që ata kanë akses në lëndët narkotike në shkollë.

Rekomandimet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë specifikojnë udhëzues dhe norma specifike për infrastrukturën brenda dhe përreth ndërtesave shkollore. Në përputhje me gjetjet nga studimi është e vështirë të besohet se këto janë ndjekur gjatë ndërtimit të gjitha shkollave. 56,1% e nxënësve raportuan se nuk kanë dalje funksionale emergjente në shkollë, dhe 2,6% e nxënësve raportojnë se në shkollë nuk ka gardhe. Ende 52,5% e nxënësve thanë se është deri diku e vërtetë ose shumë e vërtetë që nxënësit nga shkollat e tjera kanë qasje në ndërtesën e shkollës së tyre. Gjithashtu, 39,6% deklaruan se shkolla e tyre nuk ka roje sigurie dhe nga ata që kanë, 39,4% deklaruan se duhet t'i paguajnë vetë. Një 44,3% e nxënësve deklarojnë se ndjehen të kërcënuar nga qentë endacakë përreth shkollës. 52,4% e nxënësve thanë se nuk ka pengesa rrëth shkollës, ndërsa 21,7% thonë se nuk ka vendkalime për këmbësorë dhe 61,8% e nxënësve deklaruan se makinat kalojnë pranë shkollës me shpejtësi të madhe. Për sa i përket qasshmërisë, 61,3% e të anketuarve thonë se nuk ka rampë për nxënës me aftësi të kufizuara dhe 97,2% thonë se nuk ka banjo të qasshme për studentët me aftësi të kufizuara.

39,6% e nxënësve raportuan se shkolla e tyre nuk ka bibliotekë, ndërsa nga ata që kanë në 32,8% të rasteve nuk kanë bibliotekist. 26,5% e nxënësve kanë deklaruar se numri i librave nuk është i mjaftueshëm dhe 62,5% e nxënësve thonë se biblioteka nuk është e qasshme për të mësuar jashtë orarit të rregullt shkollor. Gjithashtu, 28,1% nuk e shohin se si lidhen librat me lëndët që kanë në shkollë. Edhe pse ka pasur një numër laboratorësh të reportuar në shkolla, mospërputhja midis laboratorëve ekzistues dhe laboratorëve realë funksionalë mund të shihet lehtësisht. Ndërsa 49,2% e nxënësve raportojnë 4 ose më shumë laboratorë në shkollë, vetëm 42% raportojnë 4 ose më shumë laboratorë funksionalë në shkollë.

Derisa nxënësit, veçanërisht fëmijët mbrohen ligjërisht nga çdo formë dhune (06 / L-084) tashmë është vërtetuar se përjetimi i dhunës rrit gjasat e çregullimeve të ndryshme mendore në të tashmen dhe të ardhmen (Perkins & Graham-Bermann, 2012), është bërë e qartë se sistemi arsimor përballet me mangësi serioze në përmbushjen e detyrimit për përmbushjen e këtyre premtiveve promovuese. 15,1% e nxënësve kanë raportuar të kenë mësimdhënës me përvojë që godasin nxënësit, 34,4% e nxënësve kanë përjetuar mësimdhënës që ngacmojnë nxënësit seksualisht dhe 51,4% e nxënësve kanë qenë dëshmitarë që mësimdhënësit kanë ngacmuar nxënësit. 50,5% e nxënësve thanë se ndihen keq nga fyjet e bëra nga mësimdhënësit të paktën ndonjëherë. Për më tepër, 36,3% e nxënësve janë dëshmitarë të zënkës së nxënësve me njëri-tjetrin më shumë se një herë në javë dhe 53,3% kanë raportuar se kanë qenë dëshmitarë të ngacmiveve seksuale mes nxënësve, ndërsa 79,7% kanë raportuar se nxënësit ngacmojnë njëri-tjetrin në shkollë.

Në këtë drejtim, është për t'u habitur që 84,9% e nxënësve raportojnë se nuk ka psikolog në shkollë, pavarësisht se kjo kërkohet me ligj. Nga ata që raportuan se kishin një psikolog, 36,4% raportuan nivele të ulëta besimi ndaj psikologëve, ndërsa 51,5% e atyre që kanë akses tek psikologët në shkollë janë konsultuar tashmë me ta të paktën një herë. Pra, nuk është shumë e habitshme që 52,4% e studentëve raportuan se nuk ndiheshin mirë emocionalisht në shkollë shumicën e kohës.

PËRMBAJTJA MËSIMORE

72,6% e nxënësve kanë konfirmuar se ka gabime drejtshkrimore në tekstet shkollore që përdorin dhe 58,1% kanë gjetur gabime faktike në librat e tyre shkollarë. Gjithashtu, 22,2% e nxënësve raportuan se librat e tyre shkollarë nuk kanë informacion të përditësuar në to.

Gjithashtu, 86,8% e nxënësve thanë se përdorin shkrime në klasë, ndërsa 50% e nxënësve deklaruan se përdorin libra që nuk janë pjesë e kurrikulës dhe 92,9% e nxënësve raportuan se mësimdhënësit ua diktuan mësimet.

21,2% e nxënësve mendojnë se mësimet nuk janë të dobishme për qëllimet e tyre afatgjata në arsim dhe 17% nuk mendojnë se mësimet në shkollë janë të dobishme ndërsa 23,9% nuk mendojnë se mësimet janë të dobishme për zgjidhjen e problemeve jashtë shkolle. 43,4% të tjerë nuk e shohin se shkolla i përgatit mirë për tregun e punës.

PËR
FUND

KUFIZIME

Duke qenë se ky studim ka dizajn kuantitativ të hulumtimit, vetë-raportimi është metodë kufizuese e të dhënave për shkak të subjektivitetit. Pasi një numrit të mostrës iu është administruar pyetësori, potencialisht prania e një personit të dytë gjatë përgjigjeve mund të ketë ndikuar në përgjigje. Tësia procedura e plotësimit të pyetësorve ka zgjatur shumë, gjë që potencialisht mund të ketë ndikuar në vëmendjen dhe sinjeritetin e respondentëve. Edhe pas kalimit kontrollimit të pyetësorit në tri fazë, nxënësit e përgjigjur kanë propozuar që dimensione të reja të shtohen në hulumtime të ardhshme si: uniforma, kutiat e ankesave, pedagogët, përfshirja e prindërve të fëmijëve të komuniteteve dhe qasja e stafit të shkollës. Prandaj në të ardhmen rekomandohen të përfshihen dimensionet e reja të propozuara.

Për shkak të numrit të ulët të mostrës nga komunitetet etinike dhe seksuale pakicë, nuk janë arritur të performohen analiza krahasuese. Së fundmi, kufizim i vazhdueshëm i studimeve me nxënës në Republikën e Kosovës, është mungesa e perspektivës së nxënësve të komunitetit serb. Numri i përfundimtar i pjesëmarrësve për komunë, ka qenë afër numrit ideal. Gjithashtu, zëri i nxënësve nga komuna e Mamushës, fatkeqësisht nuk ka arritur të përfaqësohet në këtë studim. Së fundmi, pasi hulumtimi ka pasur parimisht dizajn kuantitativ të hulumtimit, ne nuk mund të kuptojmë më në thelli të përvojat, sfidat dhe mendimet e nxënësve rreth cilësisë në arsim. Prandaj, hulumtimi me metodologji të përzier (cilësor dhe sasior) në të ardhmen do të zbutë këtë kufizim dhe do të hapte rrugë të reja të hulumtimit mbi cilësinë në arsim nga perspektiva e nxënësve.

REFERENCAT

- Arenliu, A., Kelmendi, K., Haskuka, M., Halimi, T., & Canhasi, E. (2013). Drug use and reported suicide ideation and attempt among Kosovar adolescents. *Journal of Substance Use*, 19(5), 358–363. doi:10.3109/14659891.2013.820803
- Buçaj, D. (2018). Koherenca e legjislacionit sekondarë me legjislacionin primarë në fushën e arsimit parauniversitar. Linku: <https://kosovotwopointzero.com/wp-content/uploads/2019/10/09-GIZ-Analyze-Finale-Koherenca-e-legjislacionit-ALB-PRESS-QUALITY.pdf>
- Komiteti Ndërministror për shkollat promovuese të shëndetit (2009). Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009-2018. Linku: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/Stretegjiaper-ShPSh-ne-Kosove.pdf>
- KYC- Student Council of Kosovo (2010). Position paper on the Quality of Education
- KYC- Student Council of Kosovo (2016). Position paper on the Quality of Education. Linku: https://issuu.com/sadrishehu5/docs/qknk_al?fbclid=IwAR0n3DgwHDuwNNBgqFDEVqYu1tbq5t2_VKAW2a9bmVMbiCrKnME73tzu0M
- Ligji për Arsimin Parauniversitar. Nr. 04/L-032 (2016). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Nr. 06/L-084 (2019). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>
- Mekolli, S. (2015) Dhuna dhe Siguria në Shkolla. Instituti Pedakogjik i Kosovës. Linku: <https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/12/Dhuna-dhe-siguria-ne-shkolla.pdf>
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2007) Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitarr 2007-2017. Linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/strategjia-per-zhvillimin-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove.pdf>
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) - Misioni në Kosovë (2018). Qasja e Komuniteteve në Arsimin parauniversitar në Kosovë. Linku: https://www.osce.org/files/Community%20Education%20report_Alb_layout.pdf
- Organization for Economic Co-operation and Development – OECD (2019) How did countries perform in PISA 2018?. Linku: <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/28450521-en.pdf?Expires=1648170328&id=id&accname=guest&checksum=9F7D184DC2C63DB19436D9AB638EF0D9>

- Perkins, S., & Graham-Bermann, S. (2012). Violence exposure and the development of school-related functioning: Mental health, neurocognition, and learning. *Aggression and Violent Behavior*, 17(1), 89–98. doi:10.1016/j.avb.2011.10.001
- Udhëzimi administrativ Nr. 08/2016 për Vlerësimin e Nxënësve (2016). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/ua-nr-08-2016-per-vleresimin-e-nxeneseve_1.pdf
- Udhëzimi Administrativ Nr. 32/2013 për Organizimin e Kurrikulës me Zgjedhje (2013). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10157>
- Udhëzimi administrativ Nr. 34/2014 për Funksionimin e Shërbimeve Pedagogjike-Psikologjike në shkolla. (2014). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/ua-34-2014.pdf>
- Udhëzuesi për Normat dhe Standartet e Ndërtesave Shkolllore (2015). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/masht-vol1-alb-print-5mm-bleed-0mm-inside-final_1.pdf
- Uka, F., Bërxulli, D., Hasani, A., Peci, B., Taravari, G., & Wiium, N. (2021). , And Among in , and. In R. Dimitrova & N. Wiium (Eds.), *Handbook of Positive Youth Development* (pp. 135–151). Springer International Publishing. https://doi.org/10.1007/978-3-030-70262-5_10

Shtojcë I

PYETËSORI PËR MATJEN E CILËSISË SË EDUKIMIT NGA PERCEPTIMI I NXËNËSVE TË SHKOLLIMIT TË MESËM TË LARTË

Qëllimi i pyetësorit për matjen e cilësisë së edukimit nga përceptimi i nxënësve të shkollimit të mesëm të lartë është të kuptojë problemet dhe shqetësimet kryesore të nxënësve në dimensione të ndryshme të cilat sigurojnë cilësi, siç janë: librat, lëndët zgjedhore, mënyra e vlerësimit dhe ligjërimi, përmbytja e qëllimeve personale të edukimit, laboratorët, zhurma, siguria në shkollë, higjiena, ndriçimi, biblioteka, shëndeti mendor, ushqimi, gjithëpërfshirja dhe përfshirja e prindërve/kujdestarëve.

1.Komuna		
2.Vendbanimi	Urban Rural	
3.Emri i shkollës dhe drejtimi		
4.Aftësi e kufizuar	Po Jo	
5.Klasa	X	
	XI	
	XII	
5. Gjinia	Vajzë Djalë Tjetër	
6.Orientimi seksual	Heteroseksual (tërhoqen nga seksa i kundërt)	
	Gej (djem që tërhoqen nga djemtë)	
	Lezbike (vajza që tërhoqen nga vajza)	
	Biseksual (tërhoqen nga më shumë se një gjini)	
	Panseksual (tërhoqen nga dikush pavarësisht gjinisë)	
	Preferoj të mos përgjigjemi	
	Tjetër	
7.Etnia	Shqiptar	
	Ashkali	
	Serb	
	Turk	
	Rom	
	Egjiptian	
	Bosnjak	
Përbajtja e librave	8.Unë kam vërejtur se tekstet e librave përbajnë gabime drejtshkrimore.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
	9.Unë kam vërejtur se tekstet e librave përbajnë gabime faktike.	3-E vërtetë deri diku
	10.Unë kam vërejtur se tekstet e librave nuk janë të rifreskuar me informata të reja,	4- Shumë e vërtetë
Përdorimi i librave	11.Ne përdorim libra për çdo lëndë mësimore.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
	12.Ne përdorim skripta për të mësuar lëndët.	3-E vërtetë deri diku
	13..Ne përdorim libra të cilat nuk janë pjesë e kurrikulës.	4- Shumë e vërtetë

Notimi	14.Unë kam marrë notë duke u vlerësuar vetëm nga një burim (me gojë, shkrim ose aktvitet) dhe jo kombinim	1-Asnjëherë
	15.Unë kam marrë notë vetëm në bazë të sjelljes sime gjatë orës së mësimit dhe jo dijes.	2-Rallë
	16.Unë jam notuar pa prezencën time.	3-Shpesh
	17.Unë jam notuar në një lëndë në bazë të notave në lëndë të tjera.	4- Gjithmonë
Praktikat e ligjërimit	18.Unë mendoj se mënyra e ligjërimit të lëndëve eshtë e mërzitshme (boring).	1-Asnjëherë
	19.Mësimdhënësit gjatë ligjërimit përdorin video për të ilustruar më mirë mësimin.	2-Rallë
	20.Mësimdhënësit përdorin mjete konktretizuese për shpjegimin e lëndëve (p.sh mësimdhënësi/ja e gjeografisë përdorë hartë, profesori i kimisë përdorë epruvetë).	3-Shpesh
	21.Mësimdhënësit i kushtojnë rëndësi interaktivitetit përmes diskutimeve.	4- Gjithmonë
	22.Mësimdhënësit kalojnë më shumë se gjysmën e orës duke ndarë informata nga jeta personale dhe jorelevante me temën.	
	23.Mësimdhënësit japidin vetëm shënimë.	
	24.Mësimdhënësit ndajnë klasën në grupe për të punuar për detyra/projekte.	
	25.Ne kemi mësimdhënës të cilët mbajnë kurse private për lëndën që ligjerojnë në shkollë.	
	26.Neve na u është diktuar mësimi nga mësimdhënësit ose nga dikush që ata kanë përcaktuar.	
Qëllimet personale të edukimit	27.Unë mendoj se mësimet në shkollë i kontribuojnë qëllimeve të mia afatgjate në edukim.	1-Aspak e vërtetë
	28.Unë mendoj se mësimet në shkollë janë të dobishme.	2-E pavërtetë deri diku
	29.Unë mendoj se mësimet në shkollë më ofrojnë mundësi të zgjedh probleme në të ardhmen.	3-E vërtetë deri diku
	30.Unë mendoj se programi i shkollës më ka përgaditur shumë për tregun e punës.	4- Shumë e vërtetë
Ndriçimi dhe klima	31.Në shkollë dhe në klasa ka mjaftushëm ndriçim.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
	32.Në shkollë është ngrahet mjaftueshëm dimrit.	3-E vërtetë deri diku
	33.Në shkollë është freskët mjaftueshëm verës.	4- Shumë e vërtetë
Pirja e duhanit në shkollë	34.Nxënësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës.	1-Asnjëherë
		2-Rallë
		3-Ndonjëherë
	35.Mësimdhënësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës.	4-Shpesh
	36.Punëtorët teknikë & mirëmbajtësit pinë duhan në ambientet e brendshme të shkollës.	4- Gjithmonë

Perceptimi i sigurisë në shkollë	37.Unë mendoj se do të mund të shpëtoja nëse gjatë kohës që jam në shkollë do të ndodhë ndonjë emergjencë si zjarr apo tèrrmet.	1-Shumë e vërtetë
	38.Në shkollën time lehtazi mund të kenë qasje nxénësit e shkollave tjera.	2-E vërtetë deri diku
	39.Brenda shkollës ka kontrolla të rregullta nga policë civilë ose policë të thjeshtë.	3-E pavërtetë deri diku
	40.Unë mendoj se është e lehtë qasja në substanca narkotike, në shkollë dhe/ose rrëth saj.	4- Aspak e vërtetë
	41.Rrugës për në shkollë dhe rrëth saj ne rezikohemi nga qentë endacakë.	
	42. Në shkollë ka shkallë emergjente funksionale	1-E vërtetë
	43. Shkolla ime është e rrëthuar (ka rrëthojë)	2- E pavërtetë
	44. Ne kemi roje sigurimi në shkollë	
	45, Nëse po: Unë paguaj për rojet e sigurimit në shkollë	
Dhuna nga mësimdhënësit	46.Në shkollë ka mësimdhënës që godasin nxénësit.	1-Asnjë mësimdhënës
		2-Pak mësimdhënës
	47.Në shkollë ka mësimdhënës që ngacmojnë seksualisht nxénësit.	3- Disa mësimdhënës
	48.Në shkollë ka mësimdhënës që ngacmojnë (bullizojnë) nxénësit.	4-Shumë mësimdhënës
Dhuna në mes të nxénësve	49.Në shkollë nxénësit grinden fizikisht me njëri tjetrin.	1-Asnjëherë
		2-Një deri dy herë në javë
		3-Dy deri tri herë në javë
		3-Tri deri katër herë në javë
		4-Katër deri pesë herë në javë
		5-Më shumë se 5 herë në javë
	50..Në shkollë ka nxénës që ngacmohen (bullizohen) nga nxénësit e tjerë.	1-Asnjëherë
		2-Rallë
		3-Shpesh
	51.Në shkollë ka nxénës që ngacmojnë seksualisht nxénësit e tjerë.	4- Gjithmonë
Përfshirja e prindërve në shkollë	52.Prindërit/kujdestarët janë zë i rëndësishëm në vendimet e shkollës.	1-Asnjëherë
		2-Rallë
		3-Shpesh
	53.Mësimdhënësit janë në kontakt me prindërit/kujdestarët.	4- Gjithmonë

Lënda zgjedhore	54.Unë kam pasur mundësinë të zgjedh lëndën zgjedhore.	1-Asnjëherë
		2-Rallë
		3-Shpesh
		4- Cjithmonë
	55.Në shkollën time janë funksionale: (shkruaj laboratorët dhe sallat funksionale).	
Biblioteka	56.Ne kemi bibotekë në shkollë.	1-E vërtetë
		2- E pavërtetë
	57. Nëse po, biblioteka ka bibliotekist/e	1-E vërtetë
		2- E pavërtetë
	58,Nëse po: Biblioteka në shkollë ka numër të mjaftueshëm të librave.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
	59.Biblioteka në shkollë është e qasshme për të mësuar pas mësimit.	3-E vërtetë deri diku
	60.Librat në bibliotekë përkojnë me mësimet/moshën/nivelin tonë akademik.	4- Shumë e vërtetë
Zhurma	61.Zhurma përreth objektit të shkollës dëmton procesin mësimor në klasë.	1-Asnjëherë
	62.Mësimdhënësit nuk arrijnë të menaxhojnë zhurmën në klasë.	2-Rallë
	63.Mësimdhënësit janë shkaktarë të zhurmës në klasë.	3-Shpesh
	64,Nxënësit janë shkaktarë të zhurmës në klasë.	4- Cjithmonë
Trafiku afér shkollës	65.Afér shkollës ka policë të shtrirë (pengesa për qëllim të ngadalësimit të shpejtësisë).	1-E vërtetë
	66.Afér shkollës ka vija të bardha për kalim të sigurt të rrugës.	2- E pavërtetë
	67.Afér shkollës kalojnë vetura me shpejtësi të madhe që rrezikojnë mirëqenien tonë.	
Higjiena	68.Në banjot e shkollës ka ujë të ngrohtë.	1-E vërtetë
		2- E pavërtetë
	69.Në banjot e shkollës ka peceta.	
	70..Në banjot e shkollës ka detergjent për larjen e duarve.	
	71. Në klasë ka numër të madh të mbeturinave.	
	72. Në shkollë ajri është i pastër	1-Asnjëherë
	73. Ka lagështi te muret (myk).	2-Rallë
	74. Nxënësit mirëmbajnë klasën (hedhin mbeturinat në shportë	3-Shpesh
	75. Mirëmbajtësit në shkollë kryejnë punën ashtu siç duhet.	4- Cjithmonë

Infrastruktura	76.Bankat, karriget dhe dyert në shkollë janë në gjendje të rregullt.	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
		3-E vërtetë deri diku
		4- Shumë e vërtetë
Siguria në shkollë	77.Në shkollë ka shkallë emergjente funksionale	1-E vërtetë
	78.Shkolla ime është e rrethuar (ka rrrethojë)	2- E pavërtetë
	79.Ne kemi roje sigurimi në shkollë	
	80. Nëse po: Unë paguaj për rojet e sigurimit në shkollë	
Shëndeti mendor	81.Në shkollë ka psikolog/e të punësuar.	1-E vërtetë
		2- E pavërtetë
	82.Nëse po: Unë i besoj psikologut/es së shkollës (për ndjenjat dhe mendimet e mijë)	1-Aspak e vërtetë
		2-E pavërtetë deri diku
		3-E vërtetë deri diku
	83.Nëse po: Unë ndihem mirë emocionalisht kur jam në shkollë.	4- Shumë e vërtetë
	84..Ofendohem nga mësimdhënësit (p.sh me fjalë fyese si: budalla, idiot/e).	1-Asnjëherë
		2-Rallë
		3-Shpesh
		4- Gjithmonë
Ushqimi	85.Kemi bufe në shkollë.	1-E vërtetë
	86.Lejohen pijet dhe ushqimet nga jashtë brenda shkollës.	2- E pavërtetë
Gjithëpërfshirja	87.Nxënësit që i përkasin komuniteteve pakicë përfshihen në aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore.	1-Asnjëherë
		2-Ndonjëherë
		3-Shpresherë
		4-Gjithmonë
		5-Nuk e di
		6-Nuk ka nxënës të komunitetit pakicë në shkollën time
	88.Në shkollë ka pjerrinë për nxënësit ose mësimdhënësit me aftësi të kufizuara .	1-E vërtetë
	89Në shkollë ka banjo të veçantë për nxënësit me aftësi të kufizuara.	2- E pavërtetë
Aktivitetet jashtë shkollore	90.Në shkollën time ekziston mundësia e angazhimit në aktivitete jashtëshkollore (p.sh klub i debatit, klub i artit etj.)	1-Asnjëherë
		3-Rrallë
		3-Shpesh
		4-Gjithmonë
		5-Nuk e di
Komenti/propozime		

Shtojcë II

Mostra përfundimtare dhe ndarja për komuna

Nr i nxënësve për komunë	Komuna	Numri i shkollave në komunë	Total
42	Arbanë	1	11
1435	Burim	2	16
935	Dardanë	3	30
1063	Deqan	2	35
525	Sharr	1	10
2487	Drenas	2	22
1528	Fushë Kosovë	3	35
6018	Ferizaj	8	126
3858	Gjakovë	6	127
4408	Gjilan	9	137
303	Hani i Elezit	1	10
190	Junik	1	10
1163	Kacanik	2	17
703	Kastriot	2	12
1446	Kline	2	19
2585	Lipjan	3	42
2268	Malisheva	3	34
167	Mamushe	0	0
3886	Mitrovica	5	62
3909	Peje	6	110
3863	Podujeve	3	88
10020	Prishtine	14	212
6503	Prizren	7	129
1620	Rahovec	4	38
120	Shtërpçë	1	12
1152	Shtime	1	24
2062	Skenderaj	3	60
2088	Therandë	3	35
1716	Viti	2	35
2679	Vushtrri	3	37
70742	TOTAL		1535

